



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

2012
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 29.03.2012

URDHËR

Nr. 124, datë 29.03.2012

PËR

AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "EKONOMI", "MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE/DIPLOMACI", "SHKENCA POLITIKE-ADMINISTRATË PUBLIKE" TË INSTITUCIONIT "SHKOLLA E LARTË PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional, në përputhje me Vendimin nr. 303, datë 13.01.2012 të Këshillit të Akreditimit, të institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë".
2. Akreditimin, në përputhje me Vendimin nr. 303, datë 13.01.2012 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë", e programeve të studimit "Bachelor" në:
 - a. "Ekonomi" me profile:
 - i. "Financë-bankë dhe kontabilitet"
 - ii. "Administrim biznesi"
 - iii. "Biznes dhe ligj"
 - b. "Marrëdhënie ndërkombëtare/Diplomaci"
 - c. "Shkenca politike-Administratë publike" me profile:
 - i. "Administratë publike"
 - ii. "Shkenca politike"

3. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” të plotësojë rekomandimet e përcaktuara në Vendimin nr. 303, datë 13.01.2012 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, dhe të raportojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për plotësimin e tyre, brenda 6 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
4. Programet e studimit të akredituara, të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, i nënshtrohen vlerësimit dhe akreditimit periodik. Bazuar në pikën 4, të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet çdo 6 vjet.
5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Institucioni “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAFAJ


MINISTËR

